

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"KeyPoint Partner"

Me cilësinë e ortakut të vetëm themelues, sot më datën 15. 01. 2025:

Esmeralda Rushiti, shtetësia shqiptare, datëlindja 04.09.1987, banuese në rruga Fitneta Rexha, Ndërtesë me nr. Pasurie 4/128-ND1, Tiranë, madhore, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, me numër personal identifikimi I75904050P;

Ka vendosur të nënshkruajnë aktin e themelimit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar(më poshtë Shoqëria), aktiviteti I të cilës rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi dhe nga Statuti I saj, I cili është pjesë përbërëse e ketij akti, së cilës I bashkëngjitet(më poshtë shtojca 1).

NENI 1

EMËRTIMI

Shoqëria emërtohet "KeyPoint Partner" Sh.p.k.

NENI 2

SELIA E SHOQËRISË

Shoqëria e ka selinë në adresën: Nërtesë me nr. Pasurie 4/128-ND1, rruga Fitneta Rexha, Tiranë.

NENI 3

KOHËZGJATJA

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit

NENI 4

OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Shoqëria "KeyPoint Partner" ka si object të veprimtarisë së saj:

- Aktivitete mbi pasuritë e patundëshme për llogari të të tretëve;
- Cdo veprimtari tjetër ligjore që ka lidhje me objektet e mësipërme të veprimtarisë.

NENI 5

Faqe 1 of 3



KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar shoqerisë është 100000 (njëqind mijë) lekë i ndarë në 1 kuotë me vlerë të një kuote 100000 lekë.

Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet, përkatësisht:

1. Esmeralda Rushiti, me kuota me vlerë të përgjithshme 100000(njëqind mijë) lekë, që përbën 100 % të kapitalit.

NENI 6

TRANSFERIMI I KAPITALIT

Pjesët e kapitalit themeltar te shoqërisë mund tu transferohen personave të tretë, që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, vetëm pasi ato I janë ofruara më parë ortakëve të tjerë të saj dhe janë refuzuar për tu blerës prej tyre me cmimin e paraqitur zyrtarisht nga ortaku shitës.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirish të transferueshme ndërmejt ortakëve.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirish të transferueshme me rrugë trashëgimie.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirish të transferueshme edhe në rast ndarjeje pasurore mes bashëkshortëve, paraardhësve dhe pasardhësve

NENI 7

ADMINISTRIMI&KOMPETENCAT

1. Me këtë akt emërohet 1(një) administrator I shoqërisë, personi si më poshtë:

Znj. Esmeralda Rushiti, qytetar shqiptar, me banim në rruga Fitnate Rexha, Tiranë, me numër personal I75904050P.

2. Administratori ka të drejtë e detyrim të:
 - a. Kryejë veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë;
 - b. Përfaqësojë shoqërinë tregtare;
 - c. Të pregatisë dhe nënshkruajë pasqyrat financiare vjetore dhe të propozojë shpërndarjen e fitimeve;
 - d. Është I autorizuar të veprojë në emër të shoqërisë në formim e sipër deri në regjistrimin e sanë qendrën kombëtare të biznesit.
 - e. Të kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe statut

NENI 8

GJUHA

Ky akt-themelimi u hartua në 3 kopje në gjuhën shqipe, dhe pasi miratohet në parim
dhe nen për nen nga Ortaku I vetëm i shoqërisë "KeyPoint Partner" Sh.p.k., nënshkruhet në
të gjitha faqet dhe kopjet, duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën origjinale.

Ortaku I vetëm themelues

Esmeralda Rushiti

Esmeralda Rushiti

